



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 101, datë 06.03.2023

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NR. 280,
DATË 10.12.2019 “PËR CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR MEDIAT” I
NDRYSHUAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 590 datë 26.11.2020 “Për miratimin e Planit Strategjik të Komunikimit për sistemin gjyqësor”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 1 të Vendimit nr. 280, datë 10.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të ndryshuar, si më poshtë:

Caktimin e gjyqtarëve të mëposhtëm, në pozicionin e Gjyqtarit për Mediat, për çdo juridiksion apeli:

Në Juridiksionin e Përgjithshëm të Apelit

1. znj. {...}- Gjyqtare për Median pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
2. znj. {...}- Gjyqtare për Median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
3. z. {...}- Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;
4. z. {...}- Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë;
5. znj. {...}- Gjyqtare për Median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat;
6. z. {...}- Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë;
7. z. {...}- Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë;
8. znj. {...}- Gjyqtare për Median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
9. z. {...}- Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;

- 10.znj. {...}- Gjyqtare për Median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;
- 11. znj. {...}- Gjyqtare për Median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë;
- 12.znj. {...}- Gjyqtare për Median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës;
- 13. z. {...}- Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;
- 14.z. {...}- Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

Në Juridiksionin e Apelit Administrativ

znj. {...}- Gjyqtare për Median pranë Gjykatës Administrative të Apelit;

Në Juridiksionin e Apelit për gjykimin e veprave penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

znj. Saida Dollani - Gjyqtare për Median pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;

2. Ngarkohen Gjyqtarët e caktuar për Mediat dhe gjykatat përkatëse të marrin masat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR